



## **Dokumentat e nevojshme për përfitimin e bursave për vitin akademik 2018-2019**

Në zbatim të V.K.M-së Nr. 39 datë 23.01.2019, për përfitimin e bursave, njoftojmë se aplikimi për t'u trajtuar me bursë do të bëhet **nga data 04 shkurt 2019 deri më 15 shkurt 2019, personalisht** nga studenti pranë zyrës së IT-së:

Dokumentat që duhet të dorëzojnë studentët sipas kategorive janë si më poshtë:

**a) Studentet, familjet e të cilëve trajtohen me ndihme ekonomike:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë familjare.
4. **Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtim me ndihmë ekonomike** nga seksioni i ndihmës ekonomike në Bashki, ku të cilësohet nr. i dosjes dhe vlera e saj. Ky dokument duhet të jetë i protokolluar, me firmë dhe me vulë.
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

**b) Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili burse Financiare:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti nga institucionet publike IAL për të dy prindërit.
3. Çertifikatë familjare.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

**c) Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë familjare.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
5. Raportin Mjeko Ligjor nga KMCAP-i (i fotokopjuar dhe i noterizuar).



6. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore apo nga zyrat e ndihmes ekonomike në Bashki për pagesën e aftësisë së kufizuar.

ç) **Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCAP-së ( Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për të dy prindërit me aftësi të kufizuar ( invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik ).
4. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit ose nga Njesia administrative vërtetimin e pagës së paaftësisë për punë.
5. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/ invalidin paraplegjik ose tetraplegjik;
6. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

d) **Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të pleqërisë për prindin/ të dy prindërit.
4. Çertifikatë Familjare.
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

dh) **Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë Familjare.
4. Vërtetim për të dy fëmijët e parë që janë student në IAL Publike.



5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

e) **Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë Familjare.
4. Fotokopje të noterizuar të statusit të jetimit.
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

ë) **Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë Familjare.
4. Vendimin e gjykatës të formës së prerë për humbjen e kujdestarisë prindërore..
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

f) **Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Vërtetimin nga Ministria e Brendshme.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

g) **Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.



3. Vërtetimin nga Ministria përkatëse.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

**Shënim:**

**Nuk përfitonë nga ky vendim individët që u takojnë shtesave sociale më lart, të cilët:**

- 1- Janë duke ndjekur një program të dytë studimi për të cilin duhet të përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
- 2- Studentët përsëritës.

**AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT NGA DATA 04.02.2019 deri në 15.02.2019.**

**PAS DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE VERIFIKIMIT NË ZYRAT QË KANË LËSHUAR DOKUMENTIN, VENDIMI PËR STUDENTËT QË DO TË PËRFITOJNË BURSË DO TË MERRET NGA BORDI I ADMINISTRIMIT.**